



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË DHJETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më datë **26.11.2019, (e Martë)**, në Biblioteken në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10h. mbledhje morën pjesë: Kryetari z.Sokol Haliti, Nënkryetari z.Hasan Aliu, kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahimimi, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dhjetë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Me lejoni të ju përshëndesë të gjithë të pranishmit, me qenë sot herët në mëngjes jemi informuar, se ne Shqipëri ka qenë një termat i përmasave jashtëzakonisht të mëdha, që ka edhe të vdekur e të lënduar. Në shenjë të solidarizimit për familjet e tyre me vëllezërit e motrat në Shqipëri, unë ju kisha lut si kuvend komunal ta bëjmë një minutë heshtje për nder të atyre të cilëve në sajë të kësaj tragjedie kanë vdekur. Ju ftoj për një minutë heshtje. Koftë i përjetshëm kujtimi për ta! Tani kalojmë te pyetjet jashtë rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! I kame disa pyetje, pyetja e parë për drejtorin e Urbanizimit. Çka është ndërmarr dhe çka është punuar rreth legalizimit të objekteve pa leje në Komunën e Vitisë. Pyetje tjetër kam rreth analizave që janë bë për ujin e pijshëm në disa shkolla në Komunën e Vitisë. Çfarë hapa janë ndërmarr në këtë drejtim. Pyetjet tjetër për drejtorin e Financave, që ka të bej me arkëtimin e të hyrave vetanake. Sa janë arkëtu dhe sa është shkalla e përqindjes. Kam një shqetësim në emër të grupit parlamentar të LDK-së, me vendimin e marrur nga Banka Qendrore e Kosovës, më 15.11.2019, rreth ngritjes së tarifave për sigurimin e automjeteve, që është dikun 26,6%. Po thirrmi vazhdimisht në popull, në pamundësi që të ndikojmë deklarativisht edhe si grup e pamë të udhës që ta shprehim, ta ngrisim këtë shqetësim. Sa i përket kësaj përqindje që është mjaft e lart dhe e papërbalueshme për qytetarët e komunës dhe me gjerë.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë ndaj dhëmbjen me viktimat e mëngjesit që u konfirmuan, shpresoj që mos të ketë të tjera. Po me behet qefi, që pas tri vite në bashkëpunim me KDI-në me media me në fund u sensibilizua edhe Komuna e Vitisë, një çështje që e kam ngrit qyshe në vitin 2016 e që ka qenë mjaft shqetësuese që në 10 shkollat e Vitisë uji ka dal i papijshëm. Nuk du ti marr kredencialet, po megjithatë është mirë që diçka është thënë në këtë drejtim. Asnjëherë nuk është ndërmarr asgjë për këto tri

vite, po shpresojmë që tash do të ketë, d.m.th Drejtoria Komunale e Arsimit, edhe pse ka qenë jo e rekomanduar po e urdhëruar nga Drejtoria e Inspeksionit që të marr diçka në këtë drejtim po nuk ka marr. E kemi thënë këtë si grup parlamentar i VV-së, kur i kemi dhënë vërejtjet tona lidhur me buxhetin, nuk është marr parasys. Një prej disa rekomandimeve ka qenë edhe ky, prandaj me të drejt edhe e kemi votu kundër. Shume keq që drejtorsha nuk është prezent e që do të duhet të ishte që të përgjigjet në pyetje. Drejtoria Komunale e Arsimit ka shpall një konkurs publik lidhur me bursat për studentët. Në vitin 2015 kuvendit komunal e ka nxjerr një rregullore për kriteret që duhet të ndahen bursat, dhe neni 3, pika 2 shumë kuart e thotë që përparësi në fitimin e të drejtës në burse do të kenë studentet që studiojnë në drejtimet deficitar. Shumë mirë më kujtohet, pasi që vi nga fusha e arsimit, edhe unë edhe kolegu Bekim kemi pas kërku që të definohen drejtimet deficitar. Sipas kësaj rregullore të aprovuar në vitin 2015 nuk janë specifiku drejtimet deficitare, ndërsa në konkursin e hapur publik nga DKA-ja, një ndër kriteret, d.m.th u vendos kriter që kanë përparësi studentët që studiojnë Fizikë, Gjuhë Gjermane dhe Matematikë, ndërsa unë kam marr shume telefonata nga studentët të cilët studiojnë lëmin e mjekësisë, stomatologjisë, fizioterapisë, u kriju një perceptim psikik, se do me thanë ata në start janë diskriminu dhe a kemi të drejt në me konkuru apo me ju kriju një amulli. Do të ishte mirë të na jepni një përgjigje ose ose me 1/3 e nënshkrimeve ta ndryshojmë këtë rregullore dhe të caktojmë cilat janë lëmit deficitare. Një pyetje për drejtorin e Financave. Kemi bë pyetje edhe për pasqyrat financiare, tek mirëmbajtja e rrugëve verore dhe dimërorë, në plan të prokurimit është 84 mijë euro, ndërsa, kur po vjen puna tek paraqitja në pasqyra financiare, e kemi dikun rreth 109 mijë e 85 euro. Kam bë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, ka kaluar nëpërmjet zyrës tuaj. Kur i kam hek borxhet e vitit 2018, këtu ka rezultu 103 mijë euro. Pse ka një rritje të kontratës një vlerë kaq të madhe kur në plan të prokurimit edhe sipas ligjit që e kame lexu tek plani i prokurimit në momentin që aprovohet plani i prokurimit dhe hynë në plan të prokurimit ajo shumë, nuk ka mundësi që të lejohet në atë masë sa është prezentu ne pasqyrat financiare

z.Nuredin Lutfiu: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Është një kërkesë e ripërsëritur nga banorët e fshatit Skifteraj, të cilët kërkojnë një kyqje në ujësjellësin e Letnicës. Është kërkesë e kamotshme, banorët kërkojnë afatin ose kur do të shqyrtohet kjo mundësi dhe a ka mundësi fshati Skifereaj të kyqet në atë ujësjellës pasi që është thënë se disa fshatra tjerë do të kyqen. Kam edhe një pyetje për drejtoreshën e Arsimit, stafi i shkollës “Dëshmorët e Vitisë” dhe nxënësit kërkojnë që kulmi të rregullohet, se pas çdo reshje të shiut ka rrjedhje prej kulmit. Kërkojnë që në afat sa më të shkurt të rregullohet.

z.Nijazi Isaku: Të nderuar të pranishëm! Edhe unë fillimisht shpreh ngushëllime për familjet e vëllezërve dhe motrave në Shqipëri. Po ashtu i urojmë shërim të lënduarve nga ky termet. Unë e kam një pyetje lidhur me ndërmarrjet publike lokale. Nuk kemi asnjë informatë ne si kuvend komunal, a kemi aksionar në këto ndërmarrje, nëse jo, atëherë duhet të caktohet aksionari, a dorëzojnë ndonjëherë raport të punës këto ndërmarrje, ku me Ligjin e Ndërmarrjeve Publike parashihet dorëzimi i raporteve tremujor dhe vjetor. Po ndalem tek ndërmarrja “Higjiena”, unë e di më herët ka qenë një aksionar i komunës, a është funksional ai aksionar deri tani edhe pse nuk ka sjellë asnjë raport nga kjo, ndërsa te “Hidromorava”, edhe pse është pjesë e “Hidromoraves” së Gjilanit, si njësi nuk ka naj informatë ne si kuvend komunal lidhje me këtë ndërmarrje, ndërsa tek ndërmarrja Stacioni i autobuzave mendoj që këtu që dy vite nuk kemi pas asnjë iniciativë për funksionalizimin e stacionit, ku në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike Lokale, stacioni i autobuzave është 100% aksionar Komuna e Vitisë. Që i bjen komuna edhe me ligj ka të drejt me e funksionalizu dhe me nda mjete financiare për funksionalizimin e kësaj ndërmarr. Është për keqardhje mos funksionalizimi i saj, kur e dimë që në seancat e kaluar me herët ka pas edhe iniciativa, po nuk kanë qenë për funksionalizimin, po ato nuk kanë kaluar. E kam një kërkesë për një rrugë në fshatin Lubisht, Avdullah Elmazi e vetmja rrugë e paasfaltuar ne Lubishtë, a keni parapa që të asfaltohet kjo

rrugë, ku sipas banorëve që i kam disa informata, kjo është parapa po është parapa vetëm gjysma. Kërkoj një përgjigje për këtë rrugë.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam një pyetje, pasi që në pranverë të këtij viti janë asfaltuar dy rrugë për të cilat Komuna e Vitisë pajtohet që punimet në rrugën nuk janë standarde e parapamë dhe të kërkuara të rruga nga xhamia që shkon nga ETC dhe rruga ka Pozharani, rruga “Hasan Prishtina”, rruga për nga xhamia për në ETC është riasfaltu, ndërsa rruga për nga Pozharani nuk është asfaltu. Po në këtë rrugë ka disa intervenime të një kompanie që i ka bë vijat e bardha dhe a do të riasfaltohet kjo rrugë prapë apo jo, a ka pranim teknik kjo rrugë, ngase që këtu edhe komuna është zotu se ka një marrëveshje me kompani që te dy rrugët do të riasfaltohen prapë për shkak se punimet ne ato rrugë nuk janë të kryera sipas standardeve të kërkuara dhe të parapara në tender.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë si pyetje kam disa, kam bë kërkesë në qasje të dokumenteve për listën e personave të punësuar me kontratë mbi vepër. Po si zakonisht, si herëve tjera më është sjell një dokument i tillë pa vulë, pa nënshkrim. Nuk e di unë arsyen, prandaj i kam kërku edhe disa fatura disa here, siç me është dhënë përgjigje për ato fatura, përgjigje jo e plotë, sepse unë kam kërku për vitin 2017-2018 dhe 2019 e këtu vetëm për vitin 2019 me është dhënë. Pastaj çështja e ujit të pijshëm. U tha me herët për kualitetin, po unë nuk po diskutoj për kualitet po po e du një pyetje për kuqje të ujësjiellësit në fsh.Remnik a ka prej juve dikush që me jep përgjigje se kur do të bëhet kjo kyçje, kur e dim se qyshe në mandatin e ish kryetarit z.Nexhmedin Arifi është bë shtrirja e rrjetit e tash kryetari momental gati dy mandate po i bë edhe ky nuk e ka implementu prandaj kërkoj një përgjigjeje. Jam dëshmitari i dy deponive, një ne fshati Remnik, atje ka rruga “Te plisoret e Remnikut” dhe një deponi në fshatin Skiferaj, në rrugën “5 Maji” dhe ju si inspeksion, a jeni në dijeni për këto deponi dhe nëse jo, pra po ju njoftoj që tani, e nëse po, kërkojnë përgjigje pse nuk është bë veprimi që të largohen ato deponi. Çfarë do të ndërmerri tash e tutje lidhur me këto deponi, çoftë për largimin e tyre, çoftë për informim e vetëdijesim të qytetarëve lidhur me këto dukuri negative.

z.Bekim Aziziz: Përshëndetje të nderuar koleg dhe ju të pranishëm! Kam pyetje për drejtoreshën e Arsimit. Kemi mbi një muaj një rast, ku në shkollën e Smirës, që një mësuese ka vdek, për një muaj nuk është shpall konkursi për një edukatore. Me sa e pash sot, është shpall konkursi edhe atë është shpall për një kohë të caktuar, e ku mbi 1 muaj nxënësit kanë mbet nëpër shpija. Kjo është një papërgjegjësi që ka ndodh tek ju, edhe pse tash edhe ky konkurs tash një muaj do ta vonon procedurën. Konkursin e fundi që e ki pas në shkollën e mesme “Kongresi i Manastirit”, ke pranu për gjuhë shqipe me bachelor e nuk ki pranu me master. E dinë këtë rast ti besoj, që këto informata naj sjell me shkrim. Çka është qekjo edukatore mbështetëse, bazë çkafit bëhen qeto pranime, ku kemi shkolla qe nuk kanë ndoshta edukatore hala, sa është e nevojshme që të jetë edukatore mbështetëse, kur e dimë që numri i nxënësve çdo ditë po bjen e po rritet numri i stafit të mësimdhënësve dhe kjo po na trego që ne vetëm do t’i dëmtojmë kategoritë tjera që do të paguan paga për raste. Një rast që e ki pas me herët, një edukatore që e ki pranu në Ramnisht dhe nuk e kanë pranu fshati, ja ki improvizu një klasë në shkollën “Bafti Haxhiu”, qysh ka ndodhë kjo drejtoresh, këto janë probleme mjaft serioze që je tu i shkaktu arsimit, veçanarisht në Komunën e Vitisë. Kisha kërku nga drejtori, keni bë analiza të asfaltit që po i shtroni, naj raport të analizave që i keni bë besoj që mundet me më ardh si informatë mu dhe në rindërtimin e komunës, drejtori i financave e besoj që edhe ju që nuk jeni në komune, e di që kati i parë, hibercukit është shtru përmbi patos. Nuk e di qysh lejohet përmbi dërrasa, përmbi patos të shtrohet hibercuki, që është shtru në katin e parë në krejt komunën, nuk e di qyshe e kanë leju këta njerëz që e mbikëqyrin këtë punë. Kërkoj pranimin teknik të kësaj, kërkoj që kjo informatë të më sjellët me shkrim.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Mu me pëlqej propozimi që i dha z.Aliu sa i përket rritjes se tarifave të sigurimit të automjeteve, mirëpo unë mendoj që ky nuk duhet me mbet vetëm shqetësim po

duhet me pas reagim, e për me reagu si qeveri komunale e kemi shumë më lehtë, përkrahjen e keni edhe të qytetarëve. Unë propozoj me thirr një protestë dhe taman me reflektu qysh na ka hije. Prapë edhe në këtë seancë do të lidhem me shtëpinë e shëndetit, është një aparat donacion, i cili ka ardh në vitin 2018 nga TIK-ka Turke, në vlerë dikun rreth 25 mijë euro, fatkeqësisht qytetarët e Komunës së Vitisë nuk mujn me i kry shërbimet në atë aparat. Është aparat ultrazë, sot qytetarët e komunës sonë detyrohen me shku në komuna tjera për me e kru një ultrazë, i cili kushton 20, 25, 30 euro, varet prej mjeku. Mendoj që është shumë e padrejtë edhe ndaj donacionit që është dhënë, po edhe ndaj qytetarëve që mos ti marrin këto shërbime të cilat janë të domosdoshëm. Unë mendoj që e di që ndoshta ka pak vështirësi sa i përket radiologut, nuk ka radiolog, është shumë lehtë me e kontraktu dikam me shërbime të veçanta me bë një ditë ose dy dita brenda javës, ku qytetari ka me mujtë me ardh dhe me u shërby. Është shumë shumë në interes të qytetarëve, edhe tek e fundit është marre me na mbet donacioni mos me shfrytëzua.

z.Vehbi Rama: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam një shqetësim tek rruga “Rexhep Bislimi”, që 6 vite një kanalizim është kërku, ka fillu që nja 30 ditë, fatkeqësisht ajo nuk është përfundu, ai kanalizim është ende i hapur, ato kupëzat nuk janë shtru 300 metra që 30 ditë, të ish kanë privat ish mbylle për 3 ditë. Aty janë shkatërru kupëzat, merrne me mend, ato që janë nxerr kanë fillu me u mëshel, kanë tepru kupëza, se që 30 ditë janë zgjeru dhe kështu që nuk ka vend, tash ky hynë ato kupëza, ato shaktat që janë vnu aty, një kamjan ka kalu atypari të tri shaktat i ka thy dhe kanë ardh i kanë vnu të tjerat. E këtu kërkoj që kapakët e shaktave të behën të hekurit e jo të jen të betoni. Kam edhe një kërkesë, ujë në Viti sa herë të bjen shi, që krejt qytetarët e Kosovës gëzohen që po bjen shi, ne në Viti hukatemi, kuku ra shi, mulnu mi mush kusijat, tengjeret se ujë nuk ka. Para gjashtë dite në Viti nuk kemi pas ujë 10 ore, deri kur do të jetë kjo gjendje.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë po i shprehi shqetësimet këtu në kuvend, po asgjë nuk po ndërmerret asnjëherë, kam pas për atë rrugën atje me pastru. Kam kërku rregullore që rregullon orarin e punës. Kam kërkuar informacione për urën që unë dyshoj që ka pas keqpërdorime, nuk me keni sjellë ende informata. Tani kam një shqetësim, në fshatin Novosellë, të rruga e “Bregut”, aty para 8 muajve është shtru asfalti dhe ka dal tash bari, shikone në foto se çfarë kualiteti ka qeverisja Sokol Haliti. Unë distriboj çokolata të cilat çokolata kanë afat 1 vit, kurse asfalti i Sokolit 8 muaj. Është mirë të shikohet dhe të bëni analizë, shine në foto.

Drejtori z.Ajet Sallahu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ligi mbi Legalizimin ka hy në fuqi me 05 Shtator 2018 dhe është prit kohë të gjate për udhëzimet administrative që e shoqërojnë atë ligj dhe këto udhëzime administrative tani janë të gatshme, ortofotot të vitit 2018 pas 5 shtator të 2018 tash i kemi në dispozicion, vetëm jemi ne përpilim të databazës dhe të fillojmë legalizimin e objekteve pa leje. Legalizimi i objekteve pa leje do të behet prej 05 shtator 2018 e mbrapa, që janë kanë të palegalizuara dhe taksa do të jetë 2 euro dhe do të jetë me një projekt ideor, kurse objektet që janë ndërto para vitit 2004 do të jen pa taks.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Çështja e ujit të pijshëm nëpër shkolla, është një shqetësim i ndërsjellët, si për juve po ashtu edhe për neve me shume si menaxhment, po dijet që çështja e ujit në ato shkolla ku nuk furnizohet me ujësjellës asnjëherë nuk mundet me pas ujë të pijshëm stabil, tu e ditë që gjendja dhe kushtet atmosferike her pas here ndryshojnë edhe për at kemi nënshkru një marrëveshje me institutin e shëndetit publik, ku e kanë përcjell gjendjen e ujit edhe në këto shkolla ka dal që në disa shkolla nuk pijet uji dhe nxënësit tani me e din sepse nuk është vetëm ky vit po janë vitet të tana që uji ne shkolla ku furnizohen me puse nuk pijet dhe është kriju një kulturë dhe një traditë që në këto shkolla nuk pijet uji. Ne kemi marr masa edhe me drejtorët e shkollave, jemi në takim edhe me inspektoratin, që në këto shkolla veç kemi fillu me klorizim ashtu si pas rekomandimeve të institutit, edhe pse prap nuk është e sigurt për arsye të reshjeve të vazhdueshme apo ndryshimeve atmosferike, edhe ju si kuvend ku planifikimi buxhetor votohet ne kuvend, këtë

rast edhe ju si këshilltar, përgjegjësia është e përbashkët kur ka të bëjë me arsimin dhe shkollat me furnizim me ujë. Pyetja tjetër ke rasti i edukatores në Smirë, një rast që është për tu ardhur keq, sepse edukatorja ka vdek, ne nuk mujmë me e parashiku vdekjen. Procedurat për rekrutim zgjasin. Aty në shkollën në Smirë, është një edukatore edhe parimisht kam mëndu mos me shpall, po me arsyetimin e fort të drejtorit, për arsye që edukatorja është në moshë të shtyme dhe nuk ka mundësi t'i mbaj 30 nxënës edhe pse shkrun që edukatoret duhet t'i mbajnë nga dy grupe. po për shkak gjendjes se saj shëndetësore dhe arsyeshmerisë së drejtorit dhe kërkesës se prindërve, e kemi shpallë edhe këtë pozitë me kohe të caktuar, për shkak të ramsjes së numrit të nxënësve. Në konkurset e fundit, po thua se të gjitha pozitat shpallen me kohë të caktuar, për shkak të ramsjes së numrit të nxënësve, që mos të rrizikohen këta që janë në sistem me të gjatë. U përmend edukatorja mbështetëse, shume kemi nevojë për edukatore mbështetëse, sidomos edhe për mësuese mbështetëse. I kemi mbi 70 fëmijë me nevoja të veçanta, ne kemi arrit një suksese në këtë vit, i kemi 4 psikologe tani në Drejtorinë e Arsimit, i kemi 3 asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, e kemi 1 mësuese special në këtë raste për shkak të kërkesës dhe arsyeshmerisë së shkollës që ka fëmijë në grupet e parafillores shume me ngecje ne zhvillim. E dini që Ligji mbi Arsimi Parauniversitar i ka obligu, që fëmijët me nevoja të veçanta të integrohen në proces të rregullt mësimorë. Jemi tu bë përpjekje edhe klasën e bashkangjitur me e mbyll dhe me i integru, mirëpo për shkak të mungesës që e kemi me mësuesa mbështetës, tu e ditë që sistemi është i ngarkum me mësues e me profesorë të panevojshëm në paralele me numër me të vogël, jemi mundu që ta zbusim situatën në këtë shkollë, edhe pse numri është mbi 800 nxënës ne atë shkollë. E kemi dergu një psikologe, një asistente, tani edhe një edukatore me insistimin e drejtorit, për shkak se numri është shumë i madh i fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje. E dini së ligji thotë, që secili fëmijë duhet me pas nga një asistente, po ne nuk mundem, për shkak të pozitive që i kemi të limituar dhe për shkak të buxhetit që e kemi të limituar në Drejtorinë e Arsimit. E ceka, te konkursi është publik, janë kriteret në udhëzimin administrativ, është komisioni profesional, janë kriteret e parapamë për çdo vend të punës, master mund të ketë lloj llojë masteri, po master që kërkohet në bazë të udhëzimit mbi normativin e personelit arsimor, të betohem se qajo kandidate nuk e ka dhe mundesh me kerku, se edhe unë kam dyshu e kamë pa ankesën, ku përgjegjësia e ka komisioni, po pasi që e kam pa ankesën e kam kerku lëndën dhe e kam pa që nuk ka master arsimor, profil edukimit arsimor dhe masteret munden të jen të natyrave të ndryshme, kështu që, për këtë jap përgjegjësi dhe mundësh me ardh lirish me i pa të gjitha dosjen dhe të gjitha procedurat janë publike, kualifikimet janë publike dhe shumë kandidat kërkojnë qasje në dokumente zyrtare e ku të gjithë i shohin. Rregullorja për bursa, është një rregullore që ndoshta është mirë me e rifresku, për arsye se kriteret i kemi përcaktu në saje të konkurseve që po i shpallim ne si Drejtori e Arsimi, e kemi pa qe lëndet, drejtimet deficitare i kemi tani Gjermanishten, Matematiken dhe Fiziken. Këto janë deficitare në komunën tonë.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pyetja e parë ishte me të hyrat vetanake në nivel të Komunës së Vitisë. Këto do t'i shihni edhe zyrtarisht kur të përgatiten pasqyrat financiare për kategori. Po ju njoftoj se me 15 Nëntor kemi arrit t'i grumbullojmë të hyrat vetanak në nivel të komunës nga të gjitha drejtoritë është një masë që nuk u grumbullu asnjëherë prej vitit 2002 kur ka hi në fuqi tatimi në pronë dhe të gjitha taksat tjera. Pra kemi me e mrrri 1 milion euro. Po planifikoj që deri në fund të vitit të tejkalohet plani i buxhetit që është i parapam 1 milion e 42 mije euro të grumbullohen për vitin 2019. Pra, jemi në kufi maksimal të një rekordi të grumbullimit të të hyrave vetanake. Kjo është përgjegjësi, vetëdijesim edhe i qytetarëve dhe i angazhimit të qeverisë komunale, pra kemi të hyra vetanake që asnjëherë nuk i kemi pas prej vitit 2002, pra jemi 1 milion deri tashti të grumbulluara, veç s'a edhe dhjetori, besoj që do ta tejkalojmë edhe planin e parapam me buxhet. Pyetja për mirëmbajtjen e rrugëve, që nuk përputhen me planin e prokurimit me shumen e pagesës. Këtu e kemi edhe drejtorin e Shërbimeve Publike, nuk kam unë shumë njohuri për këtë, po besoj që mujmë mu kanë dy aspekte të ndryshimit të kësaj strukture. Arsyerja e parë mundet me qenë borxhet e bartura ose kontratë kornizë

sipas ligjit edhe të tejkalohet plani i prokurimit. Nga Nijazia ke një pyetje, asfaltimi i rrugës “Avdullah Elmazi”. Nuk po e di për momentin, mirëpo e kemi një listë të rrugëve të planifikuar për 2019, që do të shtrohet në asfalt, nëse nuk është e parapamë, tash jemi tu e përgatitë buxhetin për asfaltimin e rrugëve rurale për vitin 2020 dhe besoj që edhe kjo rrugë do të planifikohet. Një pyetje tjetër ishte pranimi teknik i rrugës prej rrethit të xhamisë deri te “Lindi” dhe rruga nga Pozharani rruga “Hasan Prishtina”. Ky është projekt i financuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe pranimi teknik nuk është bë ende, jemi nga fundi i përmbylljes së aktiviteteve, ka pas ndryshime në këtë rrugë që janë parapa nga menaxheri i projekteve dhe mbikëqyrësi i kontratës, hala definitivisht ky projekt nuk është pranuar teknikisht, megjithatë ato vërejtjet që nashta janë të arsyeshme, ne besoj që ne fund do të rehabilitohet në tërësi. Një pyetje ke për kontrata me shërbime të veçanta nga Remziu. Unë me sa jam ne dijeni njëherë i kam sjellë kontratat, po nuk e përjashtoj mundësinë prap me jav pru listën e të gjitha kontratat e punëtorëve që janë të punësuar me kontrata shërbime të veçanta. Unë e kam pru njëherë, po nëse ka nevojë unë mundem me jav sjellë edhe njëherë. Një pyetje ka lidhur me analizat e asfaltimit që bëhen në rrugët e territorit të Komunës së Vitisë. Pyetja ke nga Bekim Azizi, po e kemi një kompani të kontraktuar me thirrje publike, është përzgjedh, emrin tash nuk e di, po e di që e bën testimin e asfalteve që a janë të shtrume sipas standardeve, tash raportet ai i bjen pozitive, se ne e kemi obligim me i marr raportet. Nëse ai e bjen raportin negativ, nëse nuk i plotëson kriteret bazë matjeve dhe analizave, na jemi të detyruar ose me e ndërru edhe njëherë e me shtru rrugën ose me përmirësu në tërësi, kështu që në këtë drejtim, nëse ka nevojë për analiza, është mirë nëse keni dyshim ju dikune me kërkua ose për të gjithë territorin e Komunës së Vitisë. Na e kemi raportin e operatorit ekonomik që merret ekskluzivisht me testimin edhe analizën e rrugëve që janë të asfaltume me asfalt. Një pyetje ke për renovimin e komunës së vjetër, hiberçuki mbi dërrasa, ju thamë të drejtën, unë nuk jam ekspert dhe nuk muj me dhënë përgjigje të saktë, po sipas projektit ajo është tu punu, tu e bë renovimin e komunës së vjetër edhe atij te tatimi ne pronë, edhe sallën e kuvendit që e ka bë i njëjti operator ekonomik tash a ban përmbi dërrasa apo nuk bën, unë nuk jam ekspert dhe nuk muj me dhënë përgjigje të saktë, po mbikëqyrja dhe planifikim që është bë me projekt është parapa që në këtë mënyrë të funksionon, të shtrohet hiberçuki. Taulantit, tha që ka bi bari në rruge atje në fshatin e Ri, edhe unë po e përjetoj rendë këtë shqetësim, do ta përcjelli tek mbikëqyrja që është bë në këtë rrugë dhe unë besoj që do te marrim masa.

z.Nexhmedin Jakupi Drejtor: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Këshilltarja Mirlinda e ngrit një çështje rreth mirëmbajtjes së rrugëve lokale. Unë i kame te dy kontratat edhe për 2018-2019. Kontrata e vitit 2018 ka qenë 55 mije 042 euro, e prej 2018 deri 2019 është kontrata e re deri në përfundim të muajit 7 ka qen 84 mijë euro. Unë ju garantoj që asnjëherë nuk e kemi tejkaluar edhe pse janë kontrata kornizë, mirëpo këtu bëhet pasi që rroket dy buxhete, dy vite kalendarik. Mundet me qenë ajo shifër që keni ardh deri 115 mijë, ama asnjëherë nuk e kemi tejkalu këtë shumë. Sa i përket çështjes që u ngrit nga Taulan Haxhiu, edhe pse ku ka kërkua ai ne kemi intervenu me kompaninë mbi dy herë, dhe po ju njoftoj që mbi 30 deponi ilegale i kemi largu, të cilat prapë po krijohen dhe ju kisha apelu te këshilltarët komunal, sikur që kanë ditë me i kërkua votat prej atyre qytetarëve me mujt me bisedu me ata qytetar me ndiku te ata qytetar që mu fut ata në sistem me pagu për mbeturina, ngase kompania nuk i largon ato pa pagesë, e tu e ditë që na e kemi një operator, një kompani që çdo ditë i grumbullon mbeturinat në qytet, përveç të dielave, andaj është mirë, që ata që nuk paguajnë për mbeturina, me shku te kompania me lidh kontratë dhe kompania shkon ja merr bërlllogun.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë e ndaj atë dhimten e ju, me rastin e tërmetit i cili i ka godite vëllezërit dhe motrat tona në Shqipëri, e në këtë rast duhet të shtrihet solidariteti që kërkohet ne ditët ne vijim edhe ndihma ndaj atyre, sepse mundet me qenë dikush prej atyre edhe pa kulm mbi kokë. Pyetja e Nijaziut ishte çështja e raportimit të ndërmarrjeve publike. Ishte fjala për “Hidromoraven” si kompani regjionale dhe “Higjiënen” e cila është kompani publiko private. “Hidromorava” e di çdo tre mujor naj

bjen ka një informatë, nuk është problematikë at për me sjellë, janë shifra të cilat shumë herë ndoshta janë shqetësuese edhe për juve. Sa i perket inkasimit, ndoshta te pagesa, po megjithatë nëse është kërkesë e juaja që ta sjellim në Kuvend, sa problem, e bimë, sidomos raportin vjetor e thirrmi edhe përfaqësuesin e “Hidromoraves”, që është e njësisë dhe vjen e i shtjellon të gjitha. Ishte një prej pyetjeve, çështja e pikimi të shkollës “Dëshmorët e Vitisë”, unë besoj që ne mbledhjen e drejtoreshave të paraqitet kjo dhe të eliminohet ai defekt. Ishte një kërkesë që Skifteraj dhe Remniku nuk kanë ujë. Shumë herë e kam thënë, se mundësia nëse ekziston në përmbushjen e kushteve, a ka munda të behet, unë e kam thanë atëherë, po e thamë edhe tash, jam idhetar që edhe ata banor ta kenë ujin nga Letnica. Po është çështje që duhet të shtrohet me kompaninë dhe me keshyr kapacitetet se sa i ka një. Mu më kanë pas thanë atëherë dhe nuk tërhiqem prej asaj që me kanë thanë, që nuk ka kapacitet. Sa i përket Sejdes, që tha me bë protestë rreth ngritjes së tarifës për sigurimin e automjeteve. Unë po thamë ndryshe, që sot kuvendi komunal, shefat e grupeve ose përfaqësuesit e partive politike me nxjerr një deklaratë të përbashkët dhe me thanë, Kuvendi Komunal i Vitisë e ngriti shqetësimin dhe është kundër kësaj rritje. Ndoshta do ta ketë at jehonën e vete me të madhe. Sa i përket “Ekohigjenes”, jemi aksionar 49% me 51 %, me 41% jemi Gjilan, Viti, Kamenicë. Ka qenë një anëtar i bordit atje të cilin e ka zgjedh kuvendi komunal.

Kryesiesu z.Naim Pira: Është mirë ne si kuvend të dalim me një deklaratë, që e shprehim shqetësimin kundër ngritjes së tarifës për sigurimin e automjeteve.

znj.Xhilsime Qamili: Pasi që vi nga sfera e shëndetësisë, në pika të shkurta do t’i përgjigjem Sejdes. Ne kemi insistuar për marrjen e ultrazërit, që të ofrojmë shërbime më cilësore dhe me të mira për qytetarët e Komunës së Vitisë, vërtet është siguruar në vitin 2018 nga TIK-a, organizata turke që në atë kohë kur është siguruar ai aparat, është shumë aparat i mirë i përsosur, kemi pas edhe radiologun kur ka punu dhe ka dhënë shërbime që i ka bë lehtësira edhe qytetarëve po edhe punëtorëve shëndetësorë, mirëpo ndërkohë drejtori vullnetarisht është larguar nga QKMF-ja dhe ka shkuar në Ferizaj të punoj. Mos mendo që nuk jemi të interesuar edhe ta funksionalizojmë at aparat, jemi shumë të interesuar, po po nuk po kemi stafë që punon me at aparat, që e njef at lëmi, po vetëm kemi aparaturë. Poseduesi mund të gjenë mënyrën ligjore si të vendoset në funksion ky aparat. Ne duhet të shikojmë këto mundësi.

znj. Mirlinda Sadiku: Unë si çështje e kame ngrit në 2016, po ekziston mundësi me intervenu tek cilësia e ujit te shkollat. Nuk është bash krejt qysh tha drejtoresha, sepse pikërisht një ndër arsytet pse VV nuk e ka votu buxhetin, ka qenë pikërisht pse nuk është nda buxhet për këtë punë në vitin 2016. Nëse nuk gaboj, në fillim të vitit 2016, fondacioni “Kosove luxemburg”, ka participu dhe ka vendos disa filtera, mirëpo sipas parametrave që i ka bë matjen, pikërisht shkresës që ju kam drejtu, Drejtorisë së Inspeksionit, ka dal që uji është prapë i pa pijshëm. Një fëmijë i cili është në klasë të parë ose parashkollor, ai kur të është i etur ka me këshyrë me shu etjen. D.m.th nuk ka egzistuar vullneti as politik, as buxhetor me përkrah si iniciativë, vetëm pse ka ardh ndoshta nga VV. Tash me një pikë po pajtohem me drejtoreshën, që kapacitetet buxhetore kur të behet buxheti ta ketë parasysh këtë, sepse është shqetësuese që 10 shkolla mos me pas ujë. Fëmija nuk e dinë, e kame pyet edhe femiun tim dhe të shokëve, me kanë thanë sa herë të ushtohemi pimë ujë. Ka mundësi me I vendos filterat, ka mundësi me sjellë ujë, ka mundësi me vendos aparatet të cilët e filtrojnë ujin, që nuk kushtoj shumë, janë diku 80 euro, d.m.th nuk ka pas vullnet prej 2016-së, shqyr që e beni të madhe edhe KDI-ja, pram ka qenë edhe në lajmet e KTV-së, e le të shpresojmë që do ta keni parasysh në buxhetet në vijim që do të vinë. Drejtor, ose unë nuk jam e kuart ose kemi një keqkuptim lidhur me këto shifra. Personalisht jam e prime me ju besu dokumenteve, sipas planit të prokurimit ka qenë e planifikuar në muajin shkurt, hapet tenderi, plani I prokurimin vjen në KPF. E pse u hap tenderi, tash po flas për vitin 2019, e kemi kornizë të nënshkrume me 07.08.2019, a në plan të prokurimit është parapa në muajin Shkurt dhe përfundon me 06.08.2020, po me ja shtu kësaj kur mi kanë prezantu pasqyrat financiare Janar – Shtator, kemi pas një shifer dikun më shumë se 100 mijë euro, po sot sapa isha në Zyrën e

Financave të z.Islami, vetëm tri fatura janë të vitit 2018, a është faktuar e 28.12, është fatura 19.12 dhe një faturë që jeni vonu me pagu me 26.10.2018, ndërsa tjerat janë krejt të vitit 2019, e që kur I kam kalkulu, ka dal dikun 133 mijë e 623 euro. D.m.th mu me ka interesu, pse një ndryshim kaq i madh. Unë i besoj këtij dokumenti.

z.Bekim Azizi: Drejtoresh, po thamë 20 nxënës janë të parashkollorëve, që 1 muaj e më shumë që kanë nejt në shpi, edhe konkursi që e ki shpall tash me tri javë duhet me shku procedura të mësimi edukator. Nuk po e di si është, ndërsa të mesit i rregullt, nëse një nxënës i hup 2 muaj ditë mësim, nuk ka të drejtë të notohej. Ti je drejtoresh politike, që nuk ki punu asnjë ditë në shkollë, vetëm i zbaton urdhërat që bënë ato kalkulimet, po mos të hi më fell se dalin shume gjëra. Drejtor, nëse me projekt ka qenë mu shtru hibercuki përmis patos, vetëm bima qat projekt, ama nuk ka njeri taman që e shtron përmis dërrasa, se ajo është sëmundje që bëhet. D.m.th në komunë, ti aty je përditë dhe e shtron hibercukin përmis dërrasa të kalbura, që ato dërrasa janë para 40 - 50 vite. At e bënë vetëm kontrolla e mirë që jeni tu e bë ju. D.m.th projekti juaj, ajo është me zi se krim, sepse ato dërrasa janë përherë aty dhe aty ka mu kanë sëmundje për here aty. E kame edhe një pyetje, drejtor kemi pas diskutu edhe me herët tek rrugët rurale, që janë asfaltimi në Smirë, të varrezat që ka qen një rrugë nja 300 metra. Jemi pas dakordu që ajo të shtrohet. Këtë vit, deri të vendi i ramjes së tre dëshmorëve, që është edhe vendi ku vizitohet, është një pjesë e prishur, po rruga qon tek varrezat e ku për çdo varrim shkohet përmis asaj rruge. Janë 300 metra, jemi pas dakordu që këtë vit me u rregullu kjo rrugë, mirëpo asnjë veprim nuk e keni marr. Kjo rrugë është kanë më e nevojshme se shumë rrugë që i keni shtru. Tash me prishjen e kohës, vështirësohet edhe kalimi në këtë rrugë.

znj.Fatbardha Emini: Bekim, po e përsëris edhe një here, edukatore në at shkolle ka, numri I nxënësve, përqindja që e ka një edukatore është e mjaftueshme, po për shkak gjendjes shëndetësore të asaj edukatore, jemi detyru me e marr edhe një edukatore. Vlerësimin për gjendjen shëndetësore për pensionim të parakohshëm për rilicencim për performancë të mësimdhënësve është kompetencë ekskluzive e inspektoratit të Arsimit. Na jemi menaxher të procedurave administrative, me e ngrit cilësinë, me i menaxhu shkollat në mënyrën më të mirë, po jo me e monitoru mësimdhënësin, se si po shpjegon. Sa i përket provojës në arsim, unë i kam mbi 9 vite pune në arsim. Arsim nuk është vetëm shkolla, arsim është edhe institucionet e larta arsimore dhe ato parashkollorë. Kështu që, mos spekuloni shumë, se përndryshe nuk ka humbur aty procesi arsimor, sepse vlerësimi I nxënësve parafillor nuk është me humbje të vitit apo me nota. Përndryshe, pse nuk kanë dashur prind me I dergu te ajo edukatore është çështje personale e prindërve.

z.Bekim Azizi: Unë e ngrita çështjen administrative që e ka për detyrë. Mbi dy muaj feminë I kemi naper shpija. 20 nxansa parashkollor janë në shpi. Ti si Drejtori e Arsimit, ai vend nuk është që 1 vit, edukatorët në Smirë janë mbi 20 vite që japin mësim. Unë e kërkova përgjegjësinë që ti nuk e ki shpall vendin e punës.

z.Jakup Demiri: Drejtor, thave se deri në fund të vitit do të vie epilogu I rrugëve. Pranim teknik nuk paska, kjo me interesoj me fort, po nuk po e shoh boll seriozitet nga komuna, sepse këtu është bë shumë punë, duhet me pas parasysh që në rrugën të xhamia që ishte, është shtru rruga në 2017-2018, ndërsa në 2019 edhe at dy herë, vetëm maltretim sa ka pas për qytetarët boll. Kështu që në rregull, do të shihem prapë për këtë problematik. Tani për drejtoreshën e Arsimit. Të ishte kanë pak me e sinqertë, ti sot vetëm me at raportin e ujit, sot ti ka qenë dashur të jesh këtu gjysmë ore para neve, me na pritë, se je drejtoresh e Arsimit. E ti erdhe me vonesë, nuk i more pyetjet, u tregove e papërgjegjshme.

Kryesuesi z. Naim Pira: Për rendin e ditës për seancën e X të rregullt të Kuvendit, kemi:

Rend dite

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Vitisë.**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullorë për palestrën sportive.**

3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019-2023.**
4. **Informata mbi përgatiten e të mbjellave vjeshtore.**

Nga ekzekutivi me kanë informuar, që i kemi edhe tri pika që kanë ardh atë hokë me interes për Komunën e Vitisë. Fjalën e ka nënkryetari.

Nënkryetar z.Hasan Aliu: Ju kërkoj falje që ju kemi sjell me vonesë, mirëpo janë rrethana që kanë ardh urgjente. Një nga propozim vendimet, jemi në festën e 28 Nëntorit, të cilin gjithëherë e kemi mendu dhe është njashtu një festë gjithëkombëtare, e kemi mendu se me propozim të kryetarit të komunës dhe me miratimin e kuvendit komunal, duhet ti ndajmë 5 mirënjohje. Njeri nga propozim vendimet është ky, kemi bërë përpjekje që t'i prekim disa figura, në mesin e tyre ka disa që nuk i takojnë asaj periudhe, këta janë z.Islam Pira, për shkak se është ndërtuesi i shkollës së parë shqipe në Pozharan. Mulla Syla Tërpeza, që është mësuesi i parë nga alfabeti i manastirit, që sa përfundoj 111 vjetor i Kongresit të Manastirit. Dom Mikel Tarabulluzi, për shkak të shkollës së parë shqipe, po me një alfabet tjetër 1905. Ismet Ferizaj, tu e pas parasysh aktiviteti e vet, i lindur në Smirë dhe aktiviteti e vazhdoj në Shqipëri, është i propozuar, i cili ka qen deputet i Parlamentit të Shqipërisë. Dhe, Barije Salihu, një profesoreshë, e cila i ka bërë nderë Komunës së Vitisë dhe para pak dite ka dal në pension. Këta janë 5 personalitete të cilët një prej tyre është në jetë. Propozimi i dytë është një propozim për ndërtimin e një shkolle dhe një çerdhe, që ka ardh donacion ne vlerë prej 1 milion euro nga Bashkimi Evropian dhe duhet të ndërtohen në oborrin e shkollës "Bafti Haxhiu", që është e mirë. Dhe propozimi i tretë, që e propozon drejtori.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Edhe ky propozim vendim ka të bëjë me arsimin për hir të kompletimi të zërave buxhetore, brenda për Brenda strukturës për paga kemi suficit në programin kategoria ekonomike paga dhe mëditje për administratë 5000 euro; kategoria ekonomike për paga dhe mëditje në nenprogrami e arsimit parashkollor për 8 mijë e 250 euro dhe këto dy nënprograme mjetet me vendim të kuvendit i propozojmë Ministrisë së Financave që të bartën nën nënprogamin e arsimit të mesëm, që të dyjat në total kapin vlerën 13 mijë e 250 euro.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë po i qes në votim për miratim rendin e ditës me këto tri pika të propozuara. Kush është pro miratimit? Me dy vota kundër dhe një abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e Kuvendit Komunal të Vitisë

A ka dikush rreth pikës së parë të rendit të ditës ju lutëm? Pasi nuk ka e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatohet se me votat e të gjithëve u miratu rendi i ditës, kundër nuk ka, abstenim nuk ka.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për palestrën sportive

z.Milot Lala Drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Propozim rregulloja përcakton mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës sportive. Rregullorja bazohet në Ligjin e Sportit dhe udhëzimin administrativ 03/2015. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Remzi Salihu: Unë kam një paqartësi tek neni 7, pika 1. Po e lexoj, prej të gjitha obligimeve financiare lirohen organizatat shtetërore që bënë komuna për festat shtetërore dhe kombëtare, qofshin ato me karakter kulturorë apo sportiv, por nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave në aspektin gjuhësor, fjalia sipas mendimit tim nuk do të ishte kështu. Po unë mendoj që dhe nga aspekti juridik nuk po me tingëllon ashtu siç duhet, sepse këtu po lihet një zbrastirë që mund të manipulohet. Rreth këtij neni, unë propozoj që fjalia pas presjes nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave të hiqet fare kjo fjali ose të zëvendësohet me fjalët, por nëse organizatori përfiton nga shitja e biletave të aplikohet neni 3, pika 3.5.

Drejtori z.Milot Lala: Neni 7, pika 1, ka të bëjë, nga gjitha obligimet financiare lirohen organizatat shtetërore që bënë komuna për festat shtetërore dhe kombëtare, qofshin ato me karakter kulturorë apo sportiv, por nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave, këto kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve sportive, turnirëve të ndryshme. Po ne rast që organizatori në këtë rast nuk bën shitje të biletave lirohet nga pagesa.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë pik të rendit të ditës dhe qes në votim për miratim këtë pikë të rendit të ditës, me përmirësimin të cilin e dha Remziu. Konstatoj që me votat e përgjithshme u miratu pika e rendit të ditës.

Si pikë të tretë kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në diskutim publik të Draft Strategjisë Komunale kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2019-2023

z.Heset Maliqi Zyrtar komunal: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Grupi punues i formuar nga kryetari i komunës për hartimin e kësaj strategjie, kemi punuar në draftimin e parë të këtij dokumenti, i cili është i përcjellë edhe me një plan veprimi për periudhën 2019-2023. Strategjia kundër dhunës në familje synon që të punojmë në parandalimin e dhunës në familje përmes ngritjes së vetëdijes tek komunitetit për aspektet negative të këtij fenomeni. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: Kjo do të ishte tema që kisha dashur të diskutoj, aq më pak sidomos kur të ki provojë, ku anëtari i familjes ka pesu nga dhuna. Fatkeqësisht nuk është një temë që është ma tabu. Mos harroni, kemi viktima nga dhuna në familje, pikërisht ne VV-ja me 08 Mars 2018 në vend që të dhuronte lule desh të bëj një e përkujdesje institucionale ku ju bashkuan edhe grupi i AAK-së dhe dy asamblastët e PDK-së, që e kemi bë një seancë të jashtëzakonshme, ku kemi propozu edhe pesë rekomandime, e që fatmirësisht disa prej tyre po i shof edhe në këtë strategji. Kur punohet një strategji e re gjithmonë shikohen cilat janë rezultatet që i ka sjell strategjia paraprake. Ne e kishim një mosmarrëveshje me nënkryetarin, ku më i kontestojke shifrat që i kisha marr në atë kohë nga policia lidhur me dhunën në familje, e që këtu po rezulton në këtë strategji që u vërtetu ajo që e kam dhënë unë, ku gjithmonë ju kam referu të dhënave të marra nga institucioni kredibil, e që është përgjegjëse Njësia për Dhunën në Familje, siç ishte znj.Ibadete, ku ma kofirmoj që janë kanë dikun rreth 21 raste, vitin 2018 kanë qenë 36 raste, në vitin 2019, 51 raste. Fatkeqësisht strategjia nuk i ka dhënë frytet e dëshiruara, pavarësisht se është një temë mjaft e ndjeshme dhe një temë e cila është sfidë edhe për shtetet që janë në zhvillim. Mirëpo këto shifra mu as pak nuk me gëzojnë edhe do të kisha pas qef që sinqerisht që kjo strategji të implementohet, sepse një rekomandim të cilin ne e kemi dhënë, është të ndahen mjete që të përkrahen me ushqim dhe me pagesa të qirave. Këtu na është prezentu një strategji e cila përfshihet deri në vitin 2022, mirëpo janë parapa shumë aktivitete e nuk kanë një kosto financiare. Krejt çka e kemi pa, strategjinë, në strategjinë paraprake i keni pa disa tryeza, disa punëtori, mirëpo rezultatet në praktikë po na rezultojë që nuk ka dhënë efektet e veta të caktuara. Po ashtu është shumë mirë që u parapa këtu që të ketë ndihmë falas juridike dhe sipas seancës po të atij viti, të 2018, ne si assemble kemi dal të gjithë më një deklaratë të përbashkët, ku fatmirësisht pikën të cilën jemi pajtu të gjitha grupet parlamentare kemi dal me deklaratë ne këshilltaret e Kuvendit Komunal të Vitisë, njëzëri e denojmë dhunën ne familje, ku veçojmë dhunën ndaj gruas, e cila është problem shqetësues në shoqërinë kosovare. Kërkojmë nga institucionet komunal të Vitisë, që të shikoj mundësit buxhetore për ndërtimin e një strehimore në Komunën e Vitisë si dhe kompletimin e stafin adekuat profesional. D.m.th nuk është ne këtë strategji, pse mos t'i japim një mundësi. E di që është kompetencë e nivelit qendror, po të paktën të mundohemi që të intervenohet në këtë drejtim, sepse e kam paraqit rastin kur e kemi pas seancën, që një grua është ballafaqu, nuk e kanë pranë të gjithë pikërisht që komuna nuk ka dhënë participim. Shpresoj që të punohet në këtë drejtim dhe të kihet parasysh deklaratata që u lexu.

z.Vehbi Rama: Unë mendoj që dhuna familjare ka, po jo vetëm ndaj gruas, po edhe ndaj burrave. E këtu nuk po e themi këtë. Unë në këtë strategji nuk pash kerkun që u cek dhuna ndaj burrave, po si do që të jetë, kriza familjare, ka shumë faktor, ndërsa është edhe serialet, rrjetet sociale e shume faktorë të tjerë. Po ato sun i ndalojmë, po unë e kam një propozim, që faktori i dhunës, besoj që është shumë vendimtar, është çështja ekonomike. E këtu ku ceken privilegjet apo ndihma ekonomike që ofrohen ndaj institucionit komunal, në këtë rast ndonjë ndihmë apo taksë e lirimit, që është bë naj punësim, apo vetëpunësim. Unë e kam një propozim që të shkohet jo vetëm atëherë kur të vjen te dhuna apo te divorci, po të jetë një përkrahje që të shkohet në çdo familje, sidomos vendet rurale ku nuk ka asnjë të punësuar, as burrë as grua, aty të ju afrohet kjo ndihma e komunës asaj

grue që të avancohet të punësohet apo me vet financim të lirohet nga taksat komunale. Për ato gra që kanë dhunë, është mirë me interevenu para se me bë rrumuj që të ju ndihmojmë.

z.Hasan Aliu Nënkrjetar: Unë parimisht jam parimorë, Mirëllinda duhesh me qenë edhe ti parimore, po të thojshë nuk jemi pajtu me nënkrjetarin, se nënkrjetari ka pas shifra nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, që në at drejtori është edhe ky sektor, unë ju kam referu asaj, e ti ju ke referu policisë, e ti e lave në opinion, që gjoja ti ki pas një shifër shume të saktë, e unë nuk kam pas asnjë burim. Unë kam raportu bazuar në shënimet që mi ka sjell drejtoria përkatëse, ndërsa ti i ke pas shënimet nga policia.

znj.Mirlinda Sadiku: Një sqarim, se në momentin kur kam kërkuar unë, unë e kam konkludu në bazë të dhënave që i kam marr nga policia, dhe normal që është burimi i parë aty ku raportohen rastet dhe hapen rastet. Kontestimin e keni pas sipas procesverbalit, pastaj në seancë ju keni thanë që e keni marr informatën nga drejtori dhe besoj që nuk duhet t'i kontestojmë, ku me vjen mirë që paska ramje të dhunës. Ju keni thënë 16, ndërsa unë kam thënë 21, mirëpo apo sheh që në 2017 janë raportu rastet në polici, ndërsa në qendrën për pune sociale ka më pak, a në 2018 janë 36 raste, çka kam insistu që ka ngritje prej një ngritje, ndërsa ju keni thanë ka ramje. Ti ju ke referu qendrës për punë sociale e unë policisë, të dyat janë kretibile, mirëpo në polici hapen rastet.

Kryetari z.Sokol Haliti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë erdha më vonësë, edhe unë shprehi keqardhjen time për viktimat nga tërmeti në Shqipëri që ka ndodh. Ka qenë një termet i shpërndarë që ka prek edhe Kosovën, po mbi të gjitha ka godit Durrësin jashtëzakonisht shumë. Ne institucionalisht edhe publikisht kemi shpreh keqardhjen, po jemi në gatishmëri edhe me komitetin e shpëtimit që me ndihmu me ato çka kemi mundësi si gjithherë. Ndërsa sa i përket strehimores në Gjilan, ne e kemi vendimin që e kemi ndimu at strehimore në Gjilan edhe për herën e dytë me më pak financa, po tu e zbatu udhëzimin administrativ që ka ardh nga Ministria e Financave, i cili nuk lejon mbi 500 euro vendim po duhet me apliku ne thirrje për subvencionim. Ne kemi vullnet me e ndihmu strehimoren. Jam që ata që jen të prekur nga dhuna të përkrahen si gratë dhe burrat dhe natyrisht me vullnetin tone dhe kapacitetin tone që kemi po edhe me mundësitë e lejume ligjore, financiare, juridike. Ministria për Mirëqenie Sociale do ta merr shumicën e fondeve të strehimores në Gjilan dhe do të jetë nen patronatin financiar të ministrisë, ndërsa aspektin tjetër do ta ndihmojmë edhe ne.

z.Heset Maliqi: E gjithë kjo që u diskutua ne këtë Draft Strategji, esenca është se si me mujt mos me pas dhunë ne familje. Nuk është esenca të krijojmë strehimore, po ta eliminojmë këtë defekt në shoqërinë tonë që po na përcjell përditë. Për rastet e dhunës ne familje kemi pas përkrahje dhe i ka financu strehimorja ne Gjilan po edhe në Prishtinë kemi pas raste. Mirlinda e bëri një dallim tek shifrat, unë po ju përgjigjem kështu, se nënkrjetari ka raportuar në bazë raportit që e ka dërgu Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Vetëm ta bëjmë një sqarim, policia edhe rastet që ndodhin i shtinë në regjistër të dhunës në familjen, po edhe femitë kur kanë dhunë i shtinë në dhune ne familje. Ne zhargonin social i quajmë keqtrajtim i fëmijëve, aty është bë, aty dallimi të shifrat.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Konstatoj që me votat e të gjithëve, u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katërt rendit të ditës kemi:

4. Informata mbi përgatiten e të mbjellave vjeshtore

Drejtoresha znj.Arlinda Sahiti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Komuna e Vitisë është një nder komunat me sipërfaqe më të madhe për të mbjelluar me kulturë bujqësore në Kosove. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, çdo vit harton planin e të mbjellurave vjeshtore dhe pranverore, ku në bazë të këtyre planeve, parashihet sipërfaqen që do të mbjell me kulturat e ndryshme bujqësore. Informatën e keni marr me kohë, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit z.Naim Pira: Hapim debat rreth këtyre pikave të rendit të ditës.

z.Taulant Haxhiu: Si është bë planifikimi për hektar që do të mbjellën, e ti drejtoresh kanë e ki taku prej fermerëve, a e ke taku dikan kur e dimi që fara e grurit këtë vit ka qen kogja shumë mungesë. Nuk ka pas sasi të mjaftuar, po thu që ki vizitu pikat cilat pika i ki vizitu. Unë e di, kam inforamcin që as kryesuesi i kuvendit z.Naim Pira nuk ka pas far gruri, e ka përandit vet si shume të tjera, ndërsa ti në informatë e ki cek që ka të mjaftuar farë.

z.Remzi Salihu: Unë nuk kam pyetje për drejtoreshën, po unë thamë në përgjithësi kjo informatë ashtu qyshe është sjell. Nuk ka qenë dashur të sjellët fare në rendin e ditës. Unë mendoj që me këtë informatë ka qenë dashur të na informohet mbi atë se si është bashkëpunimi i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë me bujqit, çfarë ju kanë ofruar atyre kjo drejtori, prioritetet e caktuar për kulturat bujqësore që ata duhet t'i kultivojnë si do të ndihmohen të stimulohen dhe të sigurohen bujqit e komunës sonë, se produktet e tyre do t'i plotësoj dhe do ti shesin pa vështirësi dhe pa qenë të detyruar ti hedhin në plehra si me parë. Pyes tash, se çfarë subvencioni janë ofruar, bujqve apo çfarë ndihme simbolike ju është dhënë këtyre bujqve, dhe ne fund dua ta arsyetoj apstenimi tim tek pikat e rendit të ditës po për këtë pikë e kam pas apstenim po edhe për pikat tjera që janë ardhë në mënyrë urgjente jo që jam kundër atyre tri pikave, mirëpo unë mendoj që qeto pika që po na vinë urgjente kanë një herë e ka një herë ndonjë pikë po behet për qëllime politike.

z.Nijazi Isaku: Faleminderit kryesues për këtë informatë, pajtohem me profen Remzi, sa është shume e zbehtë dhe nuk duhet mu trajtu ne kuvendin komunal një informatë me kaq pak informata, kur kemi parasysh se a është informatë vjetore apo mujore. Mendoj që ka shume pak të dhëna, sepse është një drejtori që prek shumë qytetarin e komunës sonë, ku ka subvencione shumë e mendoj që duhet me pas një trajtim me të mirë në këtë aspekt.

z.Jakup Demiri: Kjo informatë ka qenë dashur të je me e plotë, sepse është shumë e zbehet.

z.Ali Bajrami: Unë pajtohem me këtë informatë që e ka sjell drejtoresha, sepse është obligim ligjor, po krejt nga kjo çka kisha nxjerr, çekjo sipërfaqe që është këtu, lus Zotin që edhe në teren të jetë realitet, fermerët tonë t'i mbjellin këto sipërfaqe që ta sigurojnë bukën. Është një informatë që është e kufizume. Sa i përket të mbjellave vjeshtore, nuk ka domen tjetër, prandaj ajo që kërkohen në bazë të titullit e kemi në brendinë e saj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Si pikë të pestë rendit të ditës kemi

5. Propozim vendim për dekorim me mirënjohjeje

Nënkryetari me parë e prezantoja këtë pikë tani hapim debat.

z.Jakup Demiri: Shqetësim i imi për mirënjohje, nuk është për personat ne fjalë, po për shkak të keqpërdorimit të subjektit të LDK ndaj njerëzve dhe familjarëve që ju jep mirënjohje ne zgjedhjet e fundit, që edhe mirënjohjet ku i ka dhënë Sokol Haliti, ka shku i ka kërkua votat edhe për at, edhe mirënjohja e Doris Pack që e kemi dhënë mendje e keni ftu me ardh në fushatë të LDK-së.

z.Bekim Azizi: Për dekorim me mirënjohjen kuvendi a ka të drejt me i dekoru me mirënjohje, edhe me herët kemi diskutu kur të vjen një propozim duhet me ardh një biografi e secilit person, pse po e japim, çka e lidh at person me 28 Nëntorin, që është festë kombëtare. Unë mendoj që ka qenë dashur të na vjen nga një biografi për secilin për këtë. Cilat janë personat që i lidh me festen, cilët janë personat që kanë kontribu për "28 Nëntorin". Cilët janë personat që kanë kontribu për fushatën e LDK-së dhe ta dimë në bazë qkafit po shkojmë. Tash me këtë vendim po i japim mirënjohje për katër persona që nuk janë gjallë dhe të njëjtën kohë po e fusim një person që është gjallë. Mendoj që ish kanë etike të shkojmë krejt njëjtë ose një mirënjohje për një mësimdhënëse që ka dal ne pension. Sa pensionistë kanë dal që i kane bënë nga 40 vjet, ndoshta u kanë më mirë kjo të jetë për ditën e çlirimit të Vitisë. Unë nuk jam kundër as njërit prej këtyre, mirëpo ka mund të jenë edhe persona të tjerë që e kanë dhënë jetën për flamur që është dita e flamurit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim e qes në votim për miratim këtë propozim vendim. Me tri abstenime, të tjerat pro, u miratu edhe ky propozim vendim.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike nga paga e mëditje ne kategorinë e ekonomike paga e mëditje ne mes të programeve buxhetore

Edhe këtë pikë e elaboroj drejtori, se për çka është fjala. Unë tani hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim që të kaloj edhe kjo pikë. Me të gjithë pro kalon edhe kjo pikë.

Si pikë të shtat të rendit të ditës kemi:

7. Propozim vendim për ndërtimin e një objekti shkollor dhe një çerdhe publike në Komunën e Vitisë

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: E kemi një sinjal nga përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, që do ta marrim një grand. Dje pasdite na ka ardh një shkresë, që deri ka mesi i muajit dhjetor duhet të aplikohet për një grand rreth 1 milion euro, po destinimi duhet të jetë për ndërtimin e një shkolle. Ne veç me 1 milion euro, po thuaj që në Komunën e Vitisë të kemi përveç një shkolle të kemi dhe një çerdhe të fëmijëve. Tani jemi vetëm ne fazën e aplikimit. Ne sot vetëm këtë vendim do ta kompletojmë me dosjen me dokumentet tjera dhe do të aplikojmë në Komisionin e Bashkimit Evropian, që ta fitojmë këtë grand. Po procedurat thoshin që të jetë një vendim i kuvendit komunal, pasi që ishte sot kuvendi ne e sjellëm propozim vendimin.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat per kete pik të rendit të dites.

z.Bekim Azizi: Unë mendoj që krejt jemi pro këtij grand, mirëpo mendoj që ndoshta kjo pikë të jete dhe me një seancë të jashtëzakonshme e kishim mbajt, që mu kanë më e plotësime, që edhe ne me ditë a ka nevojë që në Viti me qenë edhe një shkollë e tretë, sepse 800 nxanësa me mësu me një shkollë fillore është shumë nëse nuk ka nevojë dhe mendoj që nuk ka nevojë që çerdhja të jetë në oborrin e shkollës, sepse bëhet një ngarkesë shumë e madhe. Çerdhja duhet të jetë me një vend me të qet.

z.Remzi Salihu: Pajtohem me propozimin e Bekimi, po unë këtu e kisha shti edhe një propozim tjetër. A ka mundësi që në kuadër të këtij donacioni që të futet edhe salla e edukatës fizike ne Gjimnazin “Kuvendi i Lezhes”.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 12:20

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal
Naim Pira
